

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit “Donitex” me seli në Sveti Nikolla të Republikës së Maqedonisë, të cilin e përfaqëson me autorizim A.A. - avokat nga Prishtina, kundër të paditurës “Euro Supply Kosova”, të cilën e përfaqëson me autorizim B.J. avokat nga Prishtina për shkak të pagesës të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, C.nr.617/2014, të datës 16.11.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 10.10.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e papazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje Ekonomike, C.nr.617/2014, i datës 16.11.2015, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar nën paragrafin I. të dispozitivit, e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit “Donitex” me seli në Sveti Nikolla të Republikës së Maqedonisë dhe e ka detyruar palën e paditur që t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej 789,50 (shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë euro e pesëdhjetë cent) euro palës paditëse, në emër të borxhit kryesor me kamatë ligjore duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë/propozimit për përmbarim, të gjitha këto në afatin partitiv prej 7 (shtatë) ditëve duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim. Në paragrafin II të dispozitivit e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë së palës paditëse për shumën prej 5.306,25 euro. Ndërsa në dispozitivin III e ka detyruar palën e paditur që t’ia paguaj palës paditëse shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej 717,00 €, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.617/2014 të datës 16.11.2015 të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit ose ta prish aktgjykimin e atakuar dhe çështjen t’ia kthej Gjykatës Themelore në Prishtinë në rivendosje.

E paditura në përgjigje në ankesë i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë ankesën e të paditësit si të pabazuar dhe ta vërtetojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi dhe e paditura kanë qenë në marrëdhënie afariste të vazhdueshme, paditësi i ka shitur të paditurës mallra dhe për këtë ia ka dërguar faturat përkatëse. Paditësi me padi ka pretenduar se e paditura për mallrat e pranuar i ka mbetur borxh në shumën prej 6,095.75 €. E paditura e ka pohuar detyrimin për pagesën e borxhit prej 789.50 € por e ka kontestuar shumën e kërkuar nga paditësi prej 5,306.25 €.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, ka gjetur se paditësi i ka mbetur borxh të paditurës në shumë prej 789.50 €, ndërsa e ka refuzuar pretendimin e paditësi mbi këtë shumë me arsyetim se nga shkresat e lëndës është vërtetuar se paditësi ka paguar shumën prej 5,000.00 € për borxhin ndaj paditësit, pa e specifikuar faturën përkatëse, dhe këtë shumë ia ka zbritur nga borxhi total, pasi paditësi me asnjë provë nuk ka arritur ta dëshmojë se kjo pagesë është bërë për ndonjë faturë apo borxh tjetër jashtë borxhit që është objekt i këtij kontesti.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitën e nenit 506 të LPK-së, sepse ekstrakti financiar të cilin e ka përpiluar vet paditësi nuk përbën dokument standard afarist dhe e njëjta duhet të provohet edhe me dokumente shtesë, si fletëdërgesa, fatura, ekstrakte bankare mbi pagesat apo prova tjera mbështetëse më të cilat do të vërtetohej borxhi. Ndërsa sipas Nenit 319.1 të LPK-së, paditësi ka pasur për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e tij, kurse ai përveç kartelës së sipërcekur, nuk i ka ofruar gjykatës prova bindëse se ekziston detyrimi i të paditurit, si kusht ligjor për të kërkuar kompensimin e tij.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,
Ae.nr. 30/2016, dt. 10.10.2017

KRYETARI I KOLEGJIT,
Mahir Tutuli,d.v.